



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 207/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Laziq dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Shtime, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Shtime, për shkak të vendosjes së posterave brenda hapësirës së stacionit të autobusëve, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 17.10.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Dega Shtime, subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i shqiptohet dëndimi më gjobë në vlerë prej 850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### **Arsyetim**

Me datën 08.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se me datën 08.10.2013, në Rrugën “Sheshi i UÇK-së” dhe në rrugën e Prishtinës anëtarë të PDK-së, kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetar komune, dhe flamuj mbi rrugë publike, ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës janë shkelur dispozitat ligjore mbi Zgjedhjet Lokale, neni 33 pika b) dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 09.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 10.10.2013. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga PDK, në të cilën theksohet se PDK pas marrjes se njoftimit për paraqitjen e kësaj ankesë nga ana e LVV-se menjëherë ka marr këto veprime ka larguar materiali zgjedhor (simbolet posterat etj.) te cilat ishin vendosur mbi rrugët publike, të cekura ne ankesë.

Bashkangjitur më përgjigjen në ankesë PDK, ka dërguar fotot për të cilat thuhet se kane larguar reklamat kontestuese.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

## Ankesa është e bazuar

Sipas parashtruesit të ankesës, PDK me datën 08.10.2013, në Rrugën “Sheshi i UÇK-së” dhe në rrugën e Prishtinës anëtarë të PDK-së, kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetar komune, dhe flamuj mbi rrugë publike, ku me këtë veprim kanë shkelur dispozitat ligjore mbi Zgjedhjet Lokale, nen 33 pika b) dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njofuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografitë e ofruara si provë, nga parashtruesi i ankesës, të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se posteri i kandidatit për kryetar komune nga radhët e PDK-së, është i vendosur mbi rrugët publik të cilin veprim PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se, ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njofuar me procesin zgjedhor dhe faktin se posterat e kandidatit për kryetar komune në Shtime kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjës në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitim e shkeljes, duke i larguar menjëherë fotografit nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e PDK-së është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika “b” të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit për kryetar të komunës të PDK-së janë vendosur mbi rrugët publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëershme të subjektit politik PDK-së, për evitim e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjës në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 207/2013 më datën 17.10.2013.



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkeshat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.